



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

08/2025

Sfidat ligjore të personave LGBTIQ+ dhe gazetarëve në Kosovë



Qershor 2025

Autor: Astrit Kolaj

Me kontribut të veçantë të: Blendina Veliqi dhe Zamira Krasniqi

Redaktorë: Ehat Miftaraj, Betim Musliu dhe Arrita Reznici

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Implementuar nga:



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

Mbështetur nga:



Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Kosovë.

Qershor, 2025

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

Përmbledhja ekzekutive.....	7
1. Sfidat ligjore të personave LGBTIQ+	8
1.1. Trajtimi i rasteve të personave LGBTIQ+ nga gjyqësori	8
1.1.1. Analiza e lartësisë së dënimeve.....	8
1.1.2. Respektimi i afateve ligjore procedurale.....	10
1.2. Gjuha e përdorur kundër personave LGBTIQ+	11
1.3. Sfidat e tjera të personave LGBTQ+	13
1.3.1. Mungesa e planit të veprimit për të drejtat e personave LGBTIQ+	13
1.3.2. Ndërrimi i gjinisë dhe emrit	13
1.3.3. Të drejtat pronësore të personave LGBTIQ+	13
1.3.4. Mosmiratimi i Kodit Civil.....	15
2. Sfidat ligjore të gazetarëve	15
2.1. Trajtimi i rasteve të gazetarëve nga gjyqësori	15
2.1.1. Trajtimi i rasteve në gjykatat themelore.....	16
2.1.2. Trajtimi i rasteve në Gjykatën e Apelit	17
2.2. Gjuha e përdorur kundër gazetarëve dhe mediave	19
2.3. Sfidat e tjera të gazetarëve.....	21
2.3.1. Mungesa e bazës ligjore për përgjegjësinë e mediave në raport me komentet në platformat sociale	21
2.3.2. Ofrimi i ndihmës juridike falas	22
Rekomandimet.....	24

Përmbledhja ekzekutive

Sfidat e vazhdueshme në praktikë kanë dëshmuar se personat LGBTIQ+ dhe gazetarët përballen me probleme të vazhdueshme në realizimin e të drejtave të tyre. Megjithatë Kushtetuta ofron mbrojtje të qartë, zbatimi në praktikë është i mangët për shkak të boshllëqeve ligjore dhe nënligjore, si dhe mungesës së vullnetit institucional.

Një nga sfidat më serioze për personat LGBTIQ+ është mungesa e njohjes ligjore të bashkëjetesës apo martesës mes personave të së njëjtës gjini, duke i përjashtuar ata nga e drejta për trashëgimi, pronësi të përbashkët dhe pensione familjare.

Sfida tjetër vjen nga përdorimi i gjuhës denigruese dhe kërcënuese ndaj këtyre personave. Po ashtu, mungesa e procedurave të qarta për ndërrimin e gjinisë dhe emrit i ka detyruar qytetarët të ndjekin rrugë të gjata gjyqësore. Ndërsa, mosmiratimit i Planit të veprimit për të drejtat e personave LGBTIQ+ ka ndikuar në ngecjen e fuqizimit të drejtave të tyre.

Rastet ndaj personave LGBTIQ+ janë trajtuar brenda një afati të arsyeshëm, në krahasim me veprat e tjera nga gjykatat, ndërsa është vlerësuar që politika ndëshkimore ka mundur të jetë më e ashpër.

Për gazetarët, sfida kryesore vjen nga përdorimi i gjuhës denigruese dhe kërcënuese nga zyrtarë publikë, veçanërisht gjatë debatit politik dhe në rrjete sociale. Edhe pse rastet ndaj gazetarëve janë trajtuar me prioritet nga gjykatat, dënimet ndaj kryerësve të veprave penale kundër gazetarëve, janë vlerësuar si të ulëta.

Po ashtu, mungon një rregullim i qartë për përgjegjësinë e mediave për komentet e palëve të treta në platformat e tyre online, ndonëse jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e njeh këtë përgjegjësi.

Ndërsa ndihma juridike falas është vlerësuar si shumë e rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve.

1. Sfidat ligjore të personave LGBTIQ+

1.1. Trajtimi i rasteve të personave LGBTIQ+ nga gjyqësori

Në Kosovë, ruajtja e privatësisë së personave LGBTIQ+ gjatë procedurave gjyqësore është një aspekt thelbësor që lidhet ngushtë me garantimin e të drejtave dhe dinjitetit personal. Frika nga ekspozimi publik, stigma sociale dhe mungesa e besimit te institucionet bëjnë që shumë raste të mbeten të paidentifikuara ose të pa raportuara. Mbrojtja e identitetit dhe të dhënave personale është veçanërisht e rëndësishme në rastet që trajtojnë çështje të diskriminimit apo dhunës ndaj këtij komuniteti, pasi prek direkt jetën private dhe sigurinë e individëve të përfshirë në proceset gjyqësore. Kjo situatë kërkon një qasje delikate në mënyrë që të ruhet integriteti i proceseve ligjore dhe të respektohen plotësisht të drejtat e palëve.

Ruajtja e privatësisë së personave LGBTIQ+, megjithëse esenciale për mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave themelore, shpesh paraqet një sfidë të konsiderueshme në identifikimin e rasteve sistemin gjyqësor, për çka IKD ka identifikuar dhe analizuar vetëm dy aktgjykime që lidhen me raste të personave LGBTIQ+.

Në rastin e parë, B.V. ishte akuzuar për veprën penale “përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”, kryerja e së cilës vepër dënohet me burgim në kohëzgjatje prej një (1) deri në pesë (5) vjet. Sipas aktgjykimit të shkallës së parë, i akuzuari u shpall fajtor dhe u dënua me tre (3) vjet e gjashtë (6) muaj burgim,. Ky vendim ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme e Kosovës.

Kurse, rasti i dytë ka të bëjë me tre persona të akuzuar për kryerjen e veprave penale “rrëmbimi”, “lëndimi i lehtë trupor” dhe “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”. Lidhur me veprën penale të rrëmbimit, njëri nga të akuzuarit është dënua me pesë (5) vjet burgim, ndërsa dy të tjerët janë dënua me nga katër (4) vjet burgim secili. Për veprën penale të lëndimit të lehtë trupor, të tre të akuzuarit janë dënua me nga një (1) vit burgim. Kurse, sa i përket veprës penale të armëmbajtjes pa leje, i akuzuari përkatës është dënua me gjobë në shumë prej 1,000 euro.

Lidhur me veprat penale të lartpërmendura, për të cilat të akuzuarit u shpallën fajtorë, gjykata shqiptoi dënime unike për secilin prej tyre. I akuzuari i parë u dënua me dënim unik prej pesë (5) vjetësh e gjashtë (6) muajsh, i akuzuari i dytë u dënua me katër (4) vjet e gjashtë (6) muaj burgim dhe me gjobë në shumën prej 1,000 euro, ndërsa i akuzuari i tretë u dënua me dënim unik prej katër (4) vjetësh e gjashtë (6) muajsh.

1.1.1. Analiza e lartësisë së dënimeve

IKD ka analizuar dy aktgjykime ku të përfshirë kanë qenë katër (4) persona, të cilët janë dënua për katër (4) vepra penale, ku gjithsej janë shqiptuar tetë (8) dënime.

Tri (3) nga këto dënime janë shqiptuar për veprën penale të “rrëmbimit”, tri 3 për veprën penale të “lëndimit të lehtë trupor”, një 1 për veprën penale të “armëmbajtjes pa leje”¹ dhe një 1 për veprën penale përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës. Në këto raste, dënimet e shqiptuara nga gjykata gjithsej kanë qenë shtatë 7 dënime me burgim efektiv dhe një 1 dënim me gjobë.

Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, vepra penale “përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”, me të cilën është ngarkuar i akuzuari në njërin nga rastet e analizuar, është vepër e dënueshme me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.² Në aktgjykimin e analizuar, i akuzuari për veprën penale në fjalë është dënuar me tri (3) vite e gjashtë (6) muaj burgim.³

Vepra tjetër për të cilën ishin dënuar tre 3 persona ishte vepra penale e “lëndimit të lehtë trupor”. Kjo vepër penale sipas Kodit Penal dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5).⁴ Në rastin konkret, për tre të akuzuarit gjykata ka shqiptuar dënim me burgim prej një (1) viti.

Në rastin e veprës penale të “rrëmbimit”, ku dënueshmëria sipas ligjit është dënim me burgim nga një (1) deri në dhjetë (10) vjet, gjykata ndaj të akuzuarëve ka shqiptuar dënim me burgim prej tre (3) vite e gjashtë (6) muaj.

Ndërsa, në rastin e armëmbajtjes pa leje, i akuzuari është dënuar me dënim me gjobë prej 1000 euro. Për këtë vepër penale, Kodi Penal i Republikës së Kosovës parasheh dënimin me gjobë deri në 7.500 euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.⁵ Në këtë rast, dënimi me 1,000 euro gjobë është ndjeshëm më i ulët sesa përcaktimi maksimal i paraparë me ligj. Ky është një fenomen i përsëritur, që IKD e ka evidentuar edhe në raportin “Dënimet me gjobë – leje për armëmbajtje”, ku nga 147 raste të shqyrtuara për armëmbajtje pa leje, vetëm në një rast është shqiptuar dënim me burgim.⁶

Në këto raste kemi analizuar edhe zbatimin e Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Politikën Ndëshkimore.⁷ Në rastin e tre të akuzuarëve për veprat penale të rrëmbimit, lëndimit të lehtë trupor dhe armëmbajtjes pa leje, rrethanat lehtësuese e rënduese vetëm janë përmendur duke mos bërë asnjë shtjellim sa i përket aplikimit të tyre. Gjithashtu, për tre të akuzuarit janë marrë për bazë të njëjta rrethana, ku në secilën rast gjykata si rrethanë lehtësuese ka marrë për bazë pendimin dhe

¹ Kodi NR. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 366 (Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve).

² Po aty, neni 138.

³ “Dënohet me 3 vjet e 6 muaj burgim i akuzuari për përgatitje të sulmit terrorist ndaj komunitetit LGBTI”, betimiperdrejtesi.com, publikuar më 5 mars 2024. <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-3-vjet-e-6-muaj-burgim-i-akuzuari-per-pergatitje-te-sulmit-terrorist-ndaj-komunitetit-lgbti/> (Qasur për herë të fundit më 07.05.2025).

⁴ Kodi NR. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 185.

⁵ Po aty, neni 366.

⁶ Krasniqi, Z. “Dënimet me gjobë – Leje për Armëmbajtje”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë, Shkurt 2025. <https://kli-ks.org/denimet-me-gjobe-lejeper-armembajtje/> (Qasur për herë të fundit më 07.05.2025).

⁷ Udhëzues për Politikën Ndëshkimore, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, Botimi I. Prishtinë 2018. https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf (Qasur për herë të fundit 07.05.2025).

keqardhjen kështu duke bërë edhe dyfishim të rrethanave, pasi që keqardhja si ndjenjë për pasojat e shkaktuara është e përfshirë në rrethanën e pendimit dhe nuk mund të vlerësohet veçmas si rrethanë e pavarur. Gjithashtu, gjykata me aplikimin e këtyre rrethanave nuk ka bërë ndonjë ndërlidhje me parimet dhe qëllimet e dënimit të cilat janë të parapara me këtë udhëzues.⁸

Ndërsa, në rastin e të akuzuarit për veprën penale “përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”, gjykata ka marrë për bazë rrethanat lehtësuese; 1) mosha e re, 2) të qenurit prind, 3) mënyra e sjellje para kryerjes së veprës penale, 4) pandënueshmëria më parë. Si rrethanë rënduese ka aplikuar, 1) intensiteti i rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, 2) mënyra e kryerjes së veprës penale dhe 3) pesha e rëndë e veprës penale. Edhe në këtë rast, aktgjykimi vetëm i ka listuar këto rrethana, duke mos dhënë arsyetim mbi aplikimin e tyre në rastin konkret. Duke u bazuar në këto rrethana dhe parimet e dënimit, gjykata pa një analizë të detajuar dhe të specifikuar nën dritën e rrethanave konkrete, ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar do të arrijë qëllimet e tij.

1.1.2. Respektimi i afateve ligjore procedurale

Sa i përket respektimit të afateve procedurale të parashikuara me legjislacionin në fuqi në të dy rastet, IKD ka gjetur se institucionet e sistemit të drejtësisë kanë trajtuar rastet brenda afatit të arsyeshëm kohor, sipas afateve të përcaktuara me ligj.

Te rasti i veprave penale të rrëmbimit, lëndimit të lehtë trupor dhe armbajtës pa leje, nga kryerja e veprave penale e deri te ngritja e aktakuzës kanë kaluar 149 ditë. Ndërkaq, nga ngritja e aktakuzës e deri në nxjerrjen e aktgjykimit në shkallë të parë kanë kaluar gjithsej 241 ditë. Krahasuar me kohëzgjatjen mesatare të trajtimit të rasteve penale (1,256 ditë,⁹) kohëzgjatja e procedurës gjyqësore në rastin konkret konsiderohet të ketë qenë e arsyeshme.

Te rasti i veprës penale përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, nga arrestimi i të dyshuarit e deri te ngritja e aktakuzës kanë kaluar 207 ditë dhe 172 ditë nga dita e ngritjes së aktakuzës e deri te shpallja e aktgjykimit në shkallë të parë, që përbën një periudhë të arsyeshme kohore të trajtimit të rastit. Kjo kohëzgjatje e trajtimit të rastit është në kontrast pozitiv me mesataren e kohëzgjatjes prej 894 ditësh të procedurave të konstatuara¹⁰ në Departamentin Special të Gjykatës Themelore, ku janë theksuar vonesa të mëdha në trajtimin e rasteve që bien në kompetencën e këtij departamenti.

⁸ Udhëzues për Politikën Ndëshkimore, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, Botimi I. Prishtinë 2018. https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf (Qasur për herë të fundit 07.05.2025).

⁹ Shala, G. “Aplikimi i Jurisprudencës së GjEDNJ në Kosovë” Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë, maj 2025. <https://kli-ks.org/aplikimi-i-jurisprudences-se-gjednj-se-ne-kosove/> (Qasur për herë të fundit me 21 maj 2025).

¹⁰ Krasniqi, Z / Smajli, F. “Politika Ndëshkimore në Krimet Speciale”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë, Dhjetor 2024. <https://kli-ks.org/politika-ndeshkimore-ne-krimet-speciale/> (Qasur për herë të fundit më 06 maj 2025).

1.2. Gjuha e përdorur kundër personave LGBTIQ+

Personat LGBTIQ+ në Kosovë janë përballur dhe vazhdojnë të përballen me deklarata publike diskriminuese dhe retorike të pafavorshme. Diskursi me i ashpër publik ndaj këtyre personave është shpërfaqë nga figura publike, por edhe qytetarë të ndryshëm në kohën kur Kuvendi i Kosovës ka tentuar miratimin e Kodit Civil. Pra, një diskurs i tillë është përdorur edhe brenda Kuvendit të Kosovës nga përfaqësuesit e zgjedhur drejtpërdrejt nga populli, të cilët duke shfrytëzuar të drejtën e diskutimeve përveç që përdorën gjuhë jo parlamentare, ata u lëshuan edhe në fjalë fyese dhe gjuhë me tendencë të urrejtjes ndaj personave LGBTIQ+.

Për këtë çështje edhe Institucioni i Avokatit të Popullit ka përgatitur një raport ku ceket se në transkriptimin e debatit për Projekt Kodin Civil dhe futjen në legjislacion të martesës së të njëjtit seks janë shumë të qarta fyerjet, shpifjet dhe gjuha indirekte e urrejtjes.¹¹ Në raport thuhet se në seancën e 16 marsit 2022, deklaratat negative ndaj personave LGBTIQ+ vazhduan dhe u shprehën me zë nga disa deputetë, të cilët jo vetëm që mund të avokonin hapur për “familjen natyrore” dhe “ruajtjen e specieve” dhe “traditave”, por edhe të verbalizonin përmbajtje paragjyquese kundër çifteve të të njëjtit seks. Sipas disa deputetëve, Kodi i ri do të rrezikonte “moralin publik” dhe do të prezantonte “pangopësinë seksuale”, “degjenerimin moral”, “sëmundjen”, “shthurjen”, “sjelljet në kundërshtim me natyrën njerëzore”, “shkeljen e shenjtërisë së familjes”, “përbën një veprim që dëmton rëndë shëndetin publik, duke u bërë shkak i sëmundjeve të rënda dhe të pashërueshme, si HIV/AIDS”, si dhe “në fund të fundit rezulton me traumën sociale”.¹² Të gjitha këto përbëjnë qartazi gjuhë jo parlamentare nga deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe si rrjedhojë bien në kundërshtim me vet Rregulloren e Kuvendit.¹³

Ndërsa, gjuha fyese, shpifëse dhe indirekt urryese e përdorur nga deputetët gjatë debatit për Projekt Kodin Civil, përmes deklaratave publike dhe në rrjetet e tyre sociale ndaj personave LGBTIQ+, kishte ndikuar në nxitjen e qytetarëve. Raporti i Institucionit të Avokatit të Popullit gjente se “deklaratat e disa deputetëve në rrjetet e tyre sociale gjeneruan shumë komente të mbushura me gjuhë urrejtjeje. Komente të tilla si LGBTIQ+ janë njerëz të smuar’ dhe ‘Unë do ti varja këta njerëz midis sheshit’”.¹⁴

Qendra për barazi dhe liri të komunitetit LGBT në Kosovë (CEL) përmes një analize e ka trajtuar ndikimin që lajmet për Kodin Civil e kanë pasur në nxitjen qytetare kundër personave LGBTIQ+. Mes tjerash, në këtë analizë thuhet se lajmet dhe postimet e realizuara lidhur me Kodin Civil,

¹¹ Raporti i Avokatit të Popullit: “Gjuha në diskursin publik, në raport me detyrimet që ka shteti në garantimin e lirisë së shprehjes dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes”, faqe 34. <https://oik-rks.org/2024/02/06/raport-ex-officio-nr-1462021-gjuha-ne-diskursin-publik-ne-raport-me-detyrimet-qe-ka-shteti-ne-garantimin-e-lirise-se-shprehjes-dhe-parandalimin-e-gjuhes-se-urrejtjes/> (Qasur për herë të fundit më 02 maj 2025).

¹² Po aty, faqe 36

¹³ Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, nenet 63,64,65 dhe 66. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61266>. (Qasur për herë të fundit më 02 maj 2025).

¹⁴ Raporti i Avokatit të Popullit: “Gjuha në diskursin publik, në raport me detyrimet që ka shteti në garantimin e lirisë së shprehjes dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes”, faqe 34. <https://oik-rks.org/2024/02/06/raport-ex-officio-nr-1462021-gjuha-ne-diskursin-publik-ne-raport-me-detyrimet-qe-ka-shteti-ne-garantimin-e-lirise-se-shprehjes-dhe-parandalimin-e-gjuhes-se-urrejtjes/> (Qasur për herë të fundit më 03 maj 2025).

kryesisht përmbanin deklarata të shkurtër të deputetëve/eve rreth Kodit Civil e deklarata të figurave tjera publike.¹⁵ Tutje, shumica e komentuesve përhapën narrativa që portretizonin personat LGBTIQ+ si kërcënim për familjen, duke i cilësuar ata si degjenerim, turp, antivlerë dhe përhapës të sëmundjeve.¹⁶

Kosova ka të rregulluar bazën ligjore që sanksionon gjuhën e urrejtjes, shpifjet dhe fyerjet, duke sanksionuar këtë gjuhë me Kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes. Andaj, çdo qytetar që përmes komenteve të bëra në lajmet e publikuara në rrjete sociale, shpif, fyen apo përdor gjuhë të urrejtjes, mund të mbahet përgjegjës.

Megjithatë tri aktgjykime të Gjykatës Supreme të Kosovës, të marra gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025, në Kosovë kanë krijuar një praktikë të re gjyqësore sa i përket gjuhës së urrejtjes ndaj personave LGBTIQ+. Fillimisht me tri vendime, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës kishte vendosur të dënojë me gjobë një subjekt politik për shkelje të Kodit të Mirësjelljes gjatë fushatës zgjedhore, duke vlerësuar se deklaratat publike të kandidatëve të tyre përbënin gjuhë stigmatizuese dhe nxitëse kundër personave LGBTIQ+. Mirëpo lidhur me të njëjtat raste, Gjykata Supreme¹⁷ kishte konstatuar se ato deklarata të kandidatëve të të njëjtit subjekt politik nuk përbënin shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike dhe as nuk përmbanin elemente të gjuhës së urrejtjes sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Sipas këtij vendimi, deklaratat nuk kishin për qëllim nxitjen e dhunës apo urrejtjes dhe nuk përmbanin thirrje për veprime konkrete ndaj ndonjë grupi, duke i cilësuar ato si pjesë të diskursit të lejuar politik në kuadër të lirisë së shprehjes. Në Aktgjykimin AA.nr.28/2025 të Gjykatës Supreme të Kosovës thuhet se PZAP në mënyrë të gabuar ka aplikuar të drejtën materiale kur ka vendosur se shprehjet si: “turp ju qoftë”, pastaj “ mbrojtja e dinjitetit tonë njerëzor dhe vazhdimësisë së jetës, si të ardhmen e fëmijëve tanë nga degjenerimi dhe prishja”, “anomali sociale” si dhe “dukuri degjeneruese”, të përdorura nga kandidatë për deputetë përbëjnë gjuhë në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1, pika 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.¹⁸ Vendimet e Gjykatës Supreme mbi këtë çështje, tani në Kosovë kanë krijuar një standard të ri dhe më të ngushtë në interpretimin e gjuhës së urrejtjes. Këto aktgjykime kanë krijuar një praktikë gjyqësore ku shprehjet me përmbajtje përçmuese ndaj personave

¹⁵ Kadiu, A. “Rrjetet Sociale ku urrejtja vërshon e papenguar”. Prishtinë 2024, faqe 18. https://cel-ks.org/wp-content/uploads/2024/12/Rrjetet-Sociale_Ku-urrejtja-vershon-e-papenguar.pdf (Qasur për herë të fundit më 04 maj 2025).

¹⁶ Po aty, faqe 21

¹⁷ Aktgjykimi AA.nr.28/2025 i Gjykatës supreme të Republikës së Kosovës. https://supreme.gjyqesori-rks.org/ep-content/uploads/verdicts/SUP_AA%20_28_2025_SQ.pdf (Qasur për herë të fundit më 06 maj 2025).

Aktgjykimi AA.nr.31/2025 i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës. https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/SUP_AA%20_28_2025_SQ.pdf (Qasur për herë të fundit më 06 maj 2025).

Aktgjykimi AA.nr.33/2025 i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës. https://supreme.gjyqesori-rks.org/ep-content/uploads/verdicts/SUP_AA%20_28_2025_SQ.pdf (Qasur për herë të fundit më 06 maj 2025).

¹⁸ Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 34 (Veprimet e Ndaluara të Subjekteve Politike) paragrafi 1, pika 1.11 të thotë: “përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.

LGBTIQ+ nuk konsiderohen më automatikisht si gjuhë e urrejtjes apo si shkelje e ligjit, për aq kohë sa nuk përmbajnë thirrje të drejtpërdrejt për dhunë apo urrejtje.

1.3. Sfidat e tjera të personave LGBTIQ+

1.3.1. Mungesa e planit të veprimit për të drejtat e personave LGBTIQ+

Kosova vazhdon të mos ketë Plan të veprimit për të drejtat e personave LGBTIQ+. Nga 24 korriku 2024 kur në Platformën për Konsultime Publike¹⁹ ishte publikuar për konsultime publike ky Plan, ende nuk është miratuar nga Qeveria. Sipas Zyrës për Qeverisje të Mirë të Zyrës së Kryeministrit, ky Plan nuk është miratuar për shkak se nuk ka pas një pajtim nga ana e disa ministrive lidhur me disa aktivitete të propozuara nga OJQ-të.²⁰

Një dokument si Plani i Veprimit për të Drejtat e Personave LGBTIQ+ në Republikën e Kosovës dhe zbatimi i tij do të ndikonte ndër të tjera në avancimin e mbrojtjes juridike dhe qasjes në drejtësi, rritjen e ndjeshmërisë institucionale ndaj diskriminimit, si dhe forcimin e sigurisë dhe ngritjen e ndërgjegjësimit shoqëror për të drejtat e personave LGBTIQ+.

1.3.2. Ndërrimi i gjinisë dhe emrit

Edhe pse në Kosovë praktika gjyqësore e njeh ndërrimin e gjinisë dhe emrit, baza ligjore aktuale nuk e ka të rregulluar një gjë të tillë. Në aspekt të praktikës, vlen të ceket se në vitin 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative kishte aprovuar kërkesën e paditëses M.P., e cila kishte paditur Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Komunën e Prizrenit për refuzimin e korrigjimit të emrit dhe gjinisë nga grua në burrë. Gjykata urdhëroi komunën ta bëjë këtë korrigjim.²¹ Një vit më vonë, Gjykata e Apelit e vërtetoi këtë aktgjykim.

Kështu, mungesa e rregullimit të qartë ligjor për ndërrimin e gjinisë dhe emrit në përputhje me identitetin gjinor, i ekspozon qytetarët ndaj proceseve gjyqësore të stërzgjatura dhe të pasigurta për realizimin e të drejtave të tyre. Kjo situatë nënvizon nevojën urgjente që institucionet kompetente të plotësojnë kuadrin ligjor ekzistues, në mënyrë që të përcaktojnë qartë procedurën për ndërrimin e gjinisë dhe emrit në dokumentet zyrtare.

1.3.3. Të drejtat pronësore të personave LGBTIQ+

Në Republikën e Kosovës, legjislacioni aktual nuk njeh juridikisht martesën apo bashkëjetesën e personave të gjinisë së njëjtë. Kjo mungesë e njohjes ligjore krijon një boshllëk në mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave të personave LGBTIQ+, sidomos në aspektin pronësor. Kjo situatë bën që

¹⁹ Plani i veprimit për të drejtat e personave LGBTI në Republikën e Kosovës 2024-2026. <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42547> (Qasur për herë të fundit më 26 prill 2025).

²⁰ Përgjigjja e Zyra për Qeverisje të Mirë e Zyrës së Kryeministrit dërguar me email më 26 maj 2025.

²¹ "Apeli vërteton vendimin me të cilin një personi iu mundësua ta ndryshojë emrin dhe gjininë në Komunën e Prizrenit", betimiperdrejtesi.com publikuar më 15 mars 2024. <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-vendimin-me-te-cilin-nje-personi-iu-mundesua-ta-ndryshoje-emrin-dhe-gjinine-ne-gjendje-civile/> (Qasur për herë të fundit më 15 prill 2025).

ata të mbeten të pambrojtur përballë sfidave ligjore që dalin nga bashkëjetesa e tyre, duke i vendosur në pozitë të pabarabartë krahasuar me qytetarët e tjerë.

Me mos njohjen e bashkëjetesës apo martesës në mes gjinisë së njëjtë me Ligj, vjen deri të mbetja jashtë normave ligjore e ndarjes së pasurisë bashkëshortore, të drejtës në trashëgimi nga partneri, si dhe e drejtat në pension të bashkëshortit.

1.3.3.1. Ndarja e pasurisë bashkëshortore

Ligji për Familjen i Kosovës i cili rregullon ndarjen e pasurisë bashkëshortore, nuk e njeh një të drejtë të tillë për personat e gjinisë së njëjtë të cilët kanë bashkëjetuar. Ky ligj në nenin 14, pika 1, martesën e përkufizon si bashkësi e regjistruar ligjërisht në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes.²² Ndërsa nuk ka paraparë ndonjë forme tjetër të lidhjes apo bashkëjetesës në mes të personave të gjinisë së njëjtë, që do ta kishte vlerën, të drejtat dhe obligimet që dalin nga martesa në mes të dy personave të sekseve të kundërta.

Ligji për Familjen në Kosovë me nenin 52 ka përcaktuar parimet e ndarjes së pasurisë bashkëshortore, duke përcaktuar se asnjëri nga bashkëshortët nuk mund që në mënyrë arbitrare të privohet nga pasuria e tij.²³ Ndërsa nenet 53 deri te neni 55 kanë paraparë pjesëtimin me marrëveshje të pasurisë së përbashkët, vlerësimin e pasurisë së përbashkët në rast të mosmarrëveshjes dhe përcaktimin e pjesëve të pasurisë.²⁴ Por në situatën aktuale ligjore, dy persona të gjinisë së njëjtë të cilët kanë bashkëjetuar për një kohë të caktuar duke krijuar edhe pasuri, nëse vendosin të shkëpusin bashkëjetesën dhe nuk pajtohen për ndarjen e pasurisë së fituar gjatë bashkëjetesës, privohen nga e drejta e ndarjes së pasurisë duke u bazuar në dispozitat e lartcekura të Ligjit për Familjen në Kosovë.

1.3.3.2. E drejta trashëgimore

Kosova të drejtën e trashëgimisë e ka të rregulluar me Ligji për Trashëgiminë i Kosovës. Sipas këtij ligji, trashëgimia fitohet me ligj ose testament, ndërsa sipas nenit 11 të këtij ligji trashëgimtarë ligjorë janë: fëmijët e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, bashkëshorti, prindërit, vëllezërit e motrat dhe pasardhësit e tyre, gjyshi e gjyshja dhe pasardhësit e tyre.²⁵ Ky ligj e njeh edhe trashëgiminë në bashkësinë jashtëmartesore, ku ceket shprehimisht se burri dhe gruaja që bashkëjetojnë në një bashkësi jashtëmartesore mund të trashëgojnë njëri-tjetrin si bashkëshortë, ndërsa specifikohen edhe kushtet kur fitohet kjo e drejte.²⁶

Kjo bazë ligjore që rregullon të drejtën e trashëgimisë bashkëshortore, duke e përfshirë edhe të drejtën e trashëgimisë në bashkësinë jashtëmartesore, përjashton nga e drejta trashëgimisë personat e gjinisë së njëjtë të cilët kanë jetuar bashkë deri në vdekjen e njërit nga ta, kur edhe fitohet e drejta

²² Ligji Nr. 2004/32 për familjen në Kosovë, nenin 14, pika 1 (Martesa).

²³ Po aty, neni 52

²⁴ Po aty, neni 53 deri te neni 55

²⁵ Ligji Nr. 2004 / 26 për Trashëgiminë i Kosovës, neni 11

²⁶ Po aty, neni 28.1

për trashëgimi. Ngase në të dy rastet, edhe te martesë edhe të bashkësisë jashtëmartesore, ligji përgjatë formulimit të tij përcakton se çifti duhet të jetë heteroseksual.

1.3.3.3. E drejta në pension bashkëshortor

Në Republikën e Kosovës, e drejta e bashkëshortit ndaj mjeteve të kursimeve pensionale të bashkëshortit tjetër në rast vdekjeje rregullohet përmes Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës.²⁷ Ndërsa përmes Ligjit për skemat Pensionale të Financuara nga Shteti rregullohet e drejta bashkëshortore e pensionit familjar.²⁸

Por edhe në këtë rast, në mungesë të njohjes juridike të martesës apo bashkësisë civile të personave të gjinisë së njëjtë, këta të fundit janë të privuar edhe nga e drejta në pension bashkëshortor.

1.3.4. Mosmiratimi i Kodit Civil

Edhe Kodit Civil drejtpërdrejt nuk do të rregullonte të drejtën e personave LGBTIQ+ për të pasur të drejtë në trashëgimi bashkëshortore, apo të drejtat e tjera të lartcekura, ky kod do të hapte rrugë për të rregulluar disa nga këto çështje.

Draft i Kodit Civil i cili nuk po arrin të miratohet në Kuvendin e Kosovës, në nenin 1138 flet për martesën, ku thuhet se “Format tjera të bashkësive civile rregullohen me ligj të veçantë”.²⁹ Kjo do të shtynte drejt hartimit të një ligji të veçantë, i cili do ta rregullonte formën e lidhjes së martesave në mes personave të gjinisë së njëjtë, me çka edhe do të krijohet një situatë të re juridike, duke detyruar plotësim ndryshimin e disa ligjeve aktuale të cilat mohojnë disa të drejta të personave LGBTIQ+ që derivojnë nga lidhja martesore.

Të gjitha këto arsye, ndër të tjera edhe kanë bërë që të vlerësohet se mosmiratimi i Kodit Civil është duke mohuar të drejtat e personave që i përkasin komunitetit LGBTIQ+.³⁰

2. Sfidat ligjore të gazetarëve

2.1. Trajtimi i rasteve të gazetarëve nga gjyqësori

Në një shoqëri demokratike, gazetarët luajnë një rol thelbësor për mbrojtjen e interesit publik dhe garantimin e transparencës dhe llogaridhënies. Megjithatë, në Kosovë, përveç sulmeve nga përfaqësues të Kuvendit dhe Qeverisë përmes gjuhës denigruese, jo rrallëherë gazetarët përballen edhe me kanosje e sulme fizike nga qytetarët, për shkak të punës së tyre.

²⁷ Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, neni 12

²⁸ Ligjit Nr. 04/L-131 për skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, neni 12

²⁹ Drafti i Kodit Civil, neni 1138, pika 2. <https://md.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/06/5582524D-4557-43D6-A814-D541D7E8E037.pdf> (Qasur për herë të fundit më 14 prill 2025).

³⁰ “Profesoresha Plakolli: Mosmiratimi i Kodit Civil, mohim i të drejtave për komunitetin LGBTQ+”, betimiperdrejtesi.com publikuar më 24 gusht 2024. <https://betimiperdrejtesi.com/profesoresha-plakolli-mosmiratimi-i-kodit-civil-mohim-i-te-drejtave-per-komunitet-lgbtq/> (Qasur për herë të fundit më 14 prill 2025).

Me qëllim të parandalimit të sulmeve të gazetarëve, është e rëndësishë qendrore që politika ndëshkimore e aplikuar në këto raste të arrijë qëllimin e saj. Parandalimi i personave të tjerë nga kryerja e veprave penale është një ndër qëllime të dënimit³¹.

Megjithatë, përkundër faktit se vazhdimisht ka pasur aktgjykime dënuese në rastet ku të dëmtuar janë gazetarët, këto dënime nuk kanë shërbyer si preventivë në uljen e numrit të rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve, të cilat janë rritur vit pas viti. Nëse marrim si shembull periudhën që nga viti 2020, numri i sulmeve ndaj gazetarëve ka qenë vazhdimisht në rritje, nga 24 raste sa ishin në vitin 2020, në 53 raste në vitin 2024. Kurse, sipas AGK, në 4 muajt e parë të vitit 2025 janë regjistruar 29 raste të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve.³² Statistikisht, numër më i madh i sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve ishin kryer në vitin 2023, me gjithsej 74 raste, 30 prej të cilave kishin të bënte me rastet ku gazetarët ishin duke ndjekur ngjarjet në veri të Kosovës.³³

2.1.1. Trajtimi i rasteve në gjykatat themelore

Me qëllim që të pasqyrohet trajtimi i rasteve të kësaj natyre nga ana e gjykatave, IKD ka analizuar gjashtë aktgjykime dënuese të kësaj natyre, të nxjerra nga gjykatat themelore, ku të përfshirë kanë qenë 10 të akuzuar, të cilët janë dënuar për 11 vepra penale. Katër (4) prej këtyre dënimeve u shqiptuar për veprën penale “kanosja”, 3 për veprën penale “sulmi”, 3 për veprën penale “lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje” dhe një (1) për veprën penale “shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm”. Në këto raste, gjykatat shqiptuar gjithsej 11 dënime, pesë (5) prej të cilave me burgim efektiv dhe pesë (5) të tjera me gjobë, derisa në një (1) rast tjetër, gjykata shqiptoi vërejtje gjyqësore.

Njëri prej këtyre rasteve përfundoi me aktgjykim me urdhër ndëshkimor, në tri (3) raste të pandehurit e pranuan fajësinë në shqyrtim fillestar, derisa në dy (2) raste të tjera u zhvillua gjykim i rregullt.

Në rastet e pranimi të fajësisë, pra, kur rastet kanë përfunduar pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, kohëzgjatja mesatare e nxjerrjes së aktgjykimeve nga data e ngritjes së aktakuzë është 148 ditë. Kohëzgjatja më e shkurtër ka rezultuar të jetë 15 ditë, kurse më e gjata 292 ditë. Mesatarja e kohëzgjatjes ka rezultuar pothuajse e njëjtë edhe në të dy rastet kur të akuzuarit nuk e kanë pranuar fajësinë, konkretisht 154 ditë.

Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, veprat penale të kanosjes, për të cilat u ngarkuan të akuzuarit në rastet e analizuara janë të dënueshme me gjobë apo me burgim deri në gjashtë (6)

³¹ Kodi NR. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 38.1.1.2.

³² “AGK: 29 raste të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve në katër muajt e parë të vitit 2025”, ekonomiaonline.com publikuar më 5 maj 2025 <https://ekonomiaonline.com/agk-29-raste-te-kercenimeve-dhe-sulmeve-ndaj-gazetareve-ne-kater-muajt-e-pare-te-vitit-2025/> (Qasur për herë të fundit më 08 qershor 2025).

³³ “Sulmuesit e gazetarëve në veri s’u përballën me drejtësinë”, evropaelire.org publikuar më 2 nëntor 2023 <https://www.evropaelire.org/a/sulmuesit-e-gazetareve-veri-pa-u-gjykuar-32667318.html> (Qasur për herë të fundit më 08 qershor 2025).

muaj³⁴, respektivisht një (1) vit³⁵. Analiza e realizuar për qëllime të draftimit të këtij raporti gjënë se në tri (3) raste gjykatat shqiptuan dënime me gjobë (mesatarisht 800 euro) derisa në një (1) rast u shqiptua dënime me burgim në kohëzgjatje prej tetë (8) muajve.

Vepër tjetër penale për të cilën ishin gjetur fajtorë tre të akuzuar ishte “sulmi”. Në këto tri raste, Kodi Penal parasheh dënim me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit³⁶. Në njërin prej këtyre rasteve gjykata ka shqiptuar vërejtje gjyqësore kurse në dy rastet tjera kishte shqiptuar dënime me gjobë, nga 400 euro secilit.

Në rastin e shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm, ku dënueshmëria e përcaktuar me ligj është dënimi me burgim nga gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet, gjykata ndaj të akuzuarit shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) viteve.

Ndërkaq, në rastin për lëndim të lehtë trupor, ku parashihej dënim me burgim nga gjashtë (6) muaj, deri në tri (3) vjet, gjykata i kishte dënuar tre të akuzuarit me nga dy (2) vjet burgim secilin veç e veç.

2.1.2. Trajtimi i rasteve në Gjykatën e Apelit

IKD për qëllim të këtij raporti ka analizuar edhe katër (4) vendime të Gjykatës së Apelit, për raste të kësaj natyre. Në të katër (4) rastet, të akuzuarit kanë qenë të dënuar në shkallë të parë për veprën penale “kanosja”. Në tri (3) prej rasteve Gjykata e Apelit kishte vërtetuar aktgjykimet e shkallës së parë ndërsa në një (1) rast aktgjykimi i shkallës së parë u ndryshuar.

Në njërin rast, gjykata e shkallës së parë i kishte shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili ishte zëvendësuar me gjobë prej 4,500 euro. Kurse, në rastin tjetër, gjykata e shkallës së parë kishte shqiptuar burgim me kusht në kohëzgjatje prej një viti e gjashtë muaj. Të dy këto raste ishin vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit.

Në njërin prej rasteve është gjetur se i akuzuari ngarkohej për veprën penale formën e kualifikuar të veprës penale “kanosja”³⁷ (e dënueshme me burgim nga 1 deri në 5 vite). I njëjti ishte dënuar nga gjykata e shkallës së parë me 1 vit e 6 muaj burgim me kusht. Prokuroria kishte pretenduar se në rastin konkret ky dënim ishte tejet i butë, ku kishte potencuar faktin se i dëmtuari është gazetar dhe që rrjedhimisht është cenuar liria e shprehjes, por Gjykata e Apelit kishte konstatuar se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejt. Në rastin konkret, një prej rrethanave lehtësuese që kishte vlerësuar gjykata e shkallës së parë, ishte edhe “pendimi i thellë” dhe “premtimi se më nuk do kryejë një vepër të tillë” nga i akuzuari. Mirëpo, përkundër faktit se si rrethanë rënduese gjykata kishte gjetur se i akuzuari në këtë rast ishte recidivist, i dënuar tetë herë me vendime të formës së prerë (me burgim efektiv, gjobë dhe kusht), kjo nuk kishte ndikuar që Gjykata e shkallës së parë

³⁴ Kodi NR. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 181, paragrafi 1

³⁵ Po aty, neni 181, paragrafi 2

³⁶ Po aty, neni 184, paragrafi 1.

³⁷ Po aty, neni 184, paragrafi 4.

të shqyrtoj një dënim më të lartë dhe kjo mënyrë e vendimmarrjes nuk u ndryshua as nga Gjykata e Apelit.

Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, "Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme rënduese:.. ndonjë dënim penal të mëparshëm të personit të dënuar". Sipas Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore kjo rrethanë njihet bindjen e përgjithshme se individët të cilët kanë kryer vepra penale në të kaluarën duhet të dënohet më ashpër sesa ata të cilët nuk kanë kryer. Ajo gjithashtu pranon se dënimet e mëparshme kanë dështuar në rehabilitimin apo reformimin e kryerësit. Në esencë, qëllimi i dënimit fillon të shmanget nga perspektiva e rehabilitimit në drejtim të konceptit të parandalimit të veprave të kryerësit në të ardhmen. Përkitazi me këtë rrethanë, sipas këtij udhëzuesi, gjykata duhet të marr parasysh një mori faktorësh, siç janë: Numri i dënimeve të mëparshme, pesha e veprave të mëparshme, natyrën e veprave dhe ngjashmërinë e tyre me veprën e tanishme, kohën që ka kaluar ndërmjet dënimeve etj.³⁸ Në aktgjykimin e nxjerrë, Gjykata e Apelit nuk ka arsyetuar këta faktorë dhe arsyeshmërinë se pse përkundër faktit se i akuzuari ishte paraprakisht i dënuar tetë (8) herë, ndaj tij shqiptohet dënimi me kusht, qëllimi i të cilit dënim është mos zbatimi i dënimit për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepra penale.

Situatë e ngjashme sa i përket vlerësimit të rrethanave u gjet edhe në një aktgjykim tjetër të shkallës së parë, të konfirmuar nga Gjykata e Apelit.. Bëhet fjalë për rastin ku i akuzuari ishte dënuar me gjobë në vlerë prej 1,500 euro. Në këtë rast, gjykata kishte vlerësuar pendimin dhe premtimin e të akuzuarit se nuk do kryente më vepra penale, si rrethana lehtësuese. Përderisa, edhe në këtë rast, Gjykata kishte gjetur se i akuzuari kishte qenë paraprakisht i dënuar tri herë me vendime të formës së prerë. Përkundër kësaj, kjo nuk kishte ndikuar që Gjykata Themelore të shqiptojë një dënim më të lartë, e i cili dënim u konfirmua edhe nga Gjykata e Apelit.

Ndërkaq, në rastin tjetër (rasti i katërt), nga aktgjykimet e Gjykatës së Apelit, për veprën penale "kanosja"³⁹, që kishte të bënte me kanosjen me jetë ndaj një ekipi të gazetarëve, gjykata e shkallës së parë kishte shqiptuar dënim me gjobë, në vlerën prej 200 euro. Në këtë rast, Gjykata e Apelit kishte konstatuar se ka pasur mbivlerësim të rrethanave lehtësuese dhe mungesë vlerësimi të drejtë të rrethanave rënduese, ashtu që kjo gjykatë e kishte ndryshuar lartësinë e gjobës nga 200 në 500 euro.

Bazuar në analizën e lartcekur të të gjitha rasteve, IKD ka gjetur se nga gjashtë (6) rastet e gjykatave themelore, në vetëm dy prej tyre është vlerësuar si rrethanë rënduese fakti se vepra penale është kryer ndaj gazetarit, respektivisht gjatë kryerjes së punës së tyre. Ndërsa, nga katër

³⁸ Udhëzues për politikë ndëshkimore, Gjykata Supreme e Kosovës, faqe 97. https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf. (Qasur për herë të fundit më 08 qershor 2025).

³⁹ Kodi penal, neni 181, paragrafi 2: "Kushdo që seriozisht i kanoset personit tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do ta privojë nga jeta ose se do t'i shkaktojë lëndim të rëndë trupor, se do ta rrëmbejë ose privojë nga liria ndonjë person tjetër ose se do ta dëmtojë me armë zjarri, me shpërthim ose me mjete të tjera të rrezikshme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit".

aktgjykimet e Gjykatës së Apelit, një gjë e tillë është vlerësuar si rrethanë rënduese në vetëm një rast,

Kurse, në dy (2) prej gjashtë (6) rasteve të gjykatave themelore, gjykata ka vlerësuar se nuk ka ndonjë rrethanë rënduese.

Ndërsa, sa i përket politikës ndëshkimore, mund të arrijmë në një përfundim se për sulmet dhe kanosjet ndaj gazetarëve, dënimet nga ana e gjykatave janë relativisht të ulëta.

Politika e butë ndëshkimore në rastet ku gazetarët kanosen apo sulmohen fizikisht, duke mos u marrë parasysh fakti se të dëmtuarit janë gazetarë dhe se vepra penale është kryer për shkak të detyrës së tyre, nuk arrin ta përmbushë qëllimin e dënimin drejt parandalimit të sulmeve dhe kanosjeve me të cilat ballafaqohen gazetarët. Kjo edhe duket të jetë një ndër arsyet se pse përkundër se kemi aktgjykime dënuese, sulmet ndaj gazetarëve vazhdojnë dhe rriten. Andaj, gjyqësori duhet t'i ndjekë një politikë ndëshkimore adekuate në përputhje me dispozitat e Kodit Penal dhe Udhëzuesin të Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore.

2.2. Gjuha e përdorur kundër gazetarëve dhe mediave

Roli i mediave në një shoqëri demokratike është thelbësor për llogaridhënien, transparencën dhe informimin e publikut. Në Kosovë liria e shprehjes është e përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sipas së cilës garantohet liria e shprehjes pa u penguar nga askush. Gjithsesi vlen të ceket se kjo liri kufizohet me ligj kur përdoret në drejtim të nxitjes së dhunës.⁴⁰ Neni 42 specifikon qartë se censura ndaj mediave është e ndaluar dhe askush nuk mund ta pengojë shpërndarjen e informacionit, por ky informacion mund të kufizohet me ligj ngjashëm si në nenin e mësipërm.⁴¹ Edhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNj) ka përcaktuar se çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes e cila përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide.⁴² Lirinë e shprehjes, të mendimit, qasjes në informata të gazetarëve, por edhe vëzhgimin kritik të implementimit të pushtetit politik dhe ekonomik, e garanton Kodi i Etikës për ofruesit e shërbimeve mediale në Kosovë⁴³ dhe Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës.⁴⁴

Megjithatë kjo siguri juridike nuk ka qenë e mjaftueshme që gjuha e përdorur nga zyrtarët publik në Kosovë ndaj gazetarëve dhe mediave të arrin nivelin shqetësues për shkak të përmbajtjes denigruese, ofenduese dhe nxitëse.

⁴⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, “Neni 40- Liria e Shprehjes”.

⁴¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, “Neni 42- Liria e Mediave.”

⁴² Konventa Evropiane për të Drejtat e njeriut, neni 10 (Liria e shprehjes) https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/convention_sqi (Qasur për herë të fundit me 20 maj 2025).

⁴³ Kodi i Etikës për ofruesit e shërbimeve mediale në Kosovë, neni 2 (Fushëveprimi).

⁴⁴ Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës. Dispozitat e përgjithshme, pika 5. https://agk-ks.org/site/assets/files/2614/press-code-for-kosovo_alb_1.pdf (Qasur për herë të fundit me 24 maj 2025).

Sidomos gjatë viteve të fundit, janë vërejtur raste të përsëritura (pra, jo të izoluar) kur zyrtarët publikë kanë përdorur gjuhë të tillë ndaj gazetarëve dhe mediave.⁴⁵ Shpesh gazetarët janë cilësuar sikur iu shërbejnë interesave të Serbisë,⁴⁶ oligarkëve⁴⁷ apo janë edhe pjesë e bizneseve kriminale.⁴⁸ Kjo gjuhë shkon përtej debatit të shëndetshëm publik lidhur me rolin e mediave dhe gazetarëve, duke ndikuar negativisht në punën e tyre dhe në perceptimin e publikut.

Kjo retorikë e përdorur nga grupet politike është evidentuar edhe në Raportin e Reporterëve pa Kufij për vitin 2025, të cilët e renditën Kosovën në vendin e 99-të në botë për lirinë e medias.⁴⁹

Përveç sulmeve verbale dhe fyerjeve të personave publik kundër gazetarëve dhe mediave, një shqetësim i madh mbetet gjuha kërcënuese e shprehur nga qytetarët përmes komenteve, e cila gjuhë në masë të madhe buron nga diskursi publik i eksponentëve politik.⁵⁰

Ky diskurs publik ka nxitur komente qytetare nga më të ndryshmet. Komente që janë nxitur nga diskursi publik i lartcekur janë të natyrës si: “Ki gru q.m Plum lul balit lip”⁵¹, “Te hanen ju e fshini këtë faqe pergjithmon.edhe dilni me zyre në Kraleve”⁵², “ju jeni e keqja e kti veni o klan serbija”⁵³, “Sa kushton me te q. Na....ken shpulla gojes Qenef ?!”⁵⁴.

⁴⁵ “AGK-ja e dënon fushatën e vazhdueshme kundër mediave dhe gazetarëve nga kryeministri Kurti dhe Vetëvendosje”. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. 07 shkurt 2025.

<https://www.facebook.com/asociacioniigazetareve/posts/pfbid035Nw1gPgsEbhKDMfGdmhbNcmhmvmbrmCPu37F2L7d68LByosH9wtzu3Tv99E1paioql>. (Qasur për herë të fundit me 20 maj 2025).

⁴⁶ “Të ish-regjimit dhe të oligarkëve”, Kurti sulmon mediat në mbledhjen e qeverisë, reporteri.net, publikuar më 16 prill 2025. <https://reporteri.net/lajme/te-ish-regjimit-dhe-te-oligarkeve-kurti-sulmon-mediat-ne-mbledhjen-e-qeverise/>, (Qasur për herë të fundit me 20 maj 2025).

⁴⁷ Po aty.

⁴⁸ “AGK-ja dënon sulmin e shefit të stafit të kryeministrit, Luan Dalipi ndaj mediave”. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. <https://www.facebook.com/asociacioniigazetareve/posts/pfbid02s16QWFpF4aWTFrZcxS7NpkWKCAyYd7YtMWec3xw1DhH4cseTrDjYswbY2YusGLuUtl>, (Qasur për herë të fundit me 20 maj 2025).

⁴⁹ Reporters Without Borders, “Kosovo”, <https://rsf.org/en/country-kosovo>, (Qasur për herë të fundit me 21 Maj 2025).

⁵⁰ “Kosova më keq se Serbia për lirinë e medias: Deputetja e VV-së sulmon kryetarin e AGK-së, Xhemajl Rexhën”, nacionale.com publikuar më 2 maj 2025

<https://www.facebook.com/nacionalecom/posts/pfbid0X7Q6bG49MoxydTcMvWE9YomHmwpGc3xUjEWHz2Av9jCtoY72J81LEfwQfjDAXoml> (Qasur për herë të fundit me 21 maj 2025).

⁵¹ “Lirim Mehmetaj flet pas gjobës që Gjykata ia dha mërgimtarit që e kërcënoi”: Dënimet e vogla, i motivojnë edhe të tjerët - këta i dëgjojnë sulmet e kryeministrit, ministrit, burrit të presidentes ndaj mediave, nacionale.com publikuar më 18 prill 2025. <https://www.facebook.com/watch/?v=1003762701412418&rdid=cvxCWat4fyDCeonl> (Qasur për herë të fundit me 22 maj 2025).

⁵² “AGK-ja e dënon fushatën e vazhdueshme kundër mediave dhe gazetarëve nga kryeministri Kurti dhe Vetëvendosje”. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, publikuar 7 shkurt 2025.

<https://www.facebook.com/asociacioniigazetareve/posts/pfbid035Nw1gPgsEbhKDMfGdmhbNcmhmvmbrmCPu37F2L7d68LByosH9wtzu3Tv99E1paioql>. (Qasur për herë të fundit me 20 maj 2025).

⁵³ Po aty.

⁵⁴ “Lirim Mehmetaj flet pas gjobës që Gjykata ia dha mërgimtarit që e kërcënoi”: Dënimet e vogla, i motivojnë edhe të tjerët - këta i dëgjojnë sulmet e kryeministrit, ministrit, burrit të presidentes ndaj mediave, nacionale.com publikuar më 18 prill 2025. <https://www.facebook.com/watch/?v=1003762701412418&rdid=cvxCWat4fyDCeonl> (Qasur për herë të fundit me 22 maj 2025).

Kosova përmes Ligjit Civil kundër shpifjes dhe fyerjes, e ka të sanksionuar shpifjen dhe fyerjen⁵⁵. Për dallim nga veprat që bien në domenin civil, gjuha kërcënuese konsiderohet vepër penale e cila sanksionohet Kodin Penal të Republikës së Kosovës.⁵⁶

Përkundër faktit që gjykatat në Kosovë kanë shqiptuar dënime ndaj individëve që kanë kërcënuar gazetarë përmes komenteve në rrjete sociale, kjo dukuri shqetësuese vazhdon të jetë e pranishme.

2.3. Sfidat e tjera të gazetarëve

2.3.1. Mungesa e bazës ligjore për përgjegjësinë e mediave në raport me komentet në platformat sociale

Zhvillimi i madh i rrjeteve sociale ka transformuar mënyrën se si publiku ndërvepron me informacionin dhe median e cila e plasoi atë. Megjithatë, kjo fushë e re e marrjes së informacionit ka sjellë sfida ligjore dhe etike, veçanërisht për shkak të përdoruesve të këtyre rrjeteve që cilësohen si persona të tretë, e të cilët e kanë mundësinë e lënies së komenteve që kanë në thelb kanë përmbajtje kundërligjore.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës sipas nenit 3, pika 1.3 të statutit të vet, ka kompetencë të trajtojë edhe përmbajtjet që prodhohen në media si tekst, audio, fotografi, video apo grafika që transmetohen përmes rrjeteve sociale dhe platforma të tjera të mediave.⁵⁷ Përderisa përmbajtja mediale e publikuar në rrjetet sociale mund të vlerësohet nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, komentet e personave të tretë jo.

Kësisoj, me mekanizmat ligjor të Kosovës nuk është e rregulluar përgjegjësia që kanë mediat në raport me komentet e paligjshme. Në anën tjetër, jurisprudenca e GjEDNJ-së ka vendosur standard që publikuesi mban përgjegjësi për kontrollimin e komenteve që bëhen në platformën e tyre. Një praktikë e tillë është bërë në rastin “Sanchez kundër Francës”. Rasti në fjalë lidhej me një kandidat për anëtar të Parlamentit, i cili kishte bërë një postim në profilin e tij në rrjetin social Facebook. Pas publikimit të postimit, ai u shoqërua me një numër të madh komentesh me përmbajtje raciste, të drejtuara ndaj komunitetit mysliman. Gjykata, duke marrë parasysh natyrën dhe mënyrën e funksionimit të platformës Facebook, arriti në përfundimin se edhe autori i postimit mban përgjegjësi për përmbajtjen e komenteve të paligjshme. Kjo përgjegjësi nuk rrjedh nga vetë përmbajtja e postimit, e cila nuk ishte e jashtëligjshme, por nga fakti se ai kishte dështuar të monitoronte dhe të ndërhynte në mënyrë të duhur për të hequr komentet me përmbajtje të paligjshme.⁵⁸

⁵⁵ Ligji Nr. 02/L-65 Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2503>, (Qasur për herë të fundit me 22 maj 2025).

⁵⁶ Kodi Nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 181 (Kanosja). <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>, (Qasur për herë të fundit me 22 maj 2025).

⁵⁷ Statuti i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës, i amendamentuar në shkurt të 2013-ës. Shih për më shumë linkun: https://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Statuti_KMSHK_shqip_FINAL3.pdf, (Qasur për herë të fundit me 22 maj 2025).

⁵⁸ Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin e Sanchez kundër Francës, “CASE OF SANCHEZ v. FRANCE (Application no. 45581/15)”, paragrafët 2-24 dhe 104, Strasbourg, 2 shtator 2021, (Shih

Në këtë drejtim është e rëndësishme që mediat të ndërtojnë mekanizma adekuat për të kontrolluar komentet e paligjshme. Këta mekanizma, duhet të identifikojnë komentet e paligjshme të postuara në lajmet e postuara nga ana e tyre. Mekanizmat duhet të jenë në gjendje që pa vonesë, edhe pa njoftim nga ana e një viktime të supozuar, të fshijnë komentet e paligjshme.⁵⁹

Mediat përtej përgjegjësisë për të qenë në rregull me përmbajtjen e raportimit dhe në harmoni me ligjin, kanë përgjegjësi edhe për komentet jo të ligjshme sipas praktikës së GjEDNj-së.

Të gjendur në një situatë të tillë, Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të miratojnë bazën ligjore adekuate, që në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të përcaktohet specifikisht me ligj përgjegjësia e mediave për komentet e paligjshme të postuara në publikimet e tyre në rrjetet sociale. Megjithatë, duhet pasur parasysh se hartimi i kësaj baze ligjore duhet të bëhet në mënyrë të kujdesshme që të adresojë përgjegjësinë e mediave në këtë fushë, por në asnjë mënyrë mos të cenojë pavarësinë e mediave si dhe mos të vendosë kufizime të tepëra, të cilat mund të rezultojnë në një ndërhyrje jo proporcionale në raport me lirinë e shprehjes.

2.3.2. Ofrimi i ndihmës juridike falas

Ligji për Ndihmë Juridike Falas në Kosovës i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2012, ka synuar të garantojë qasje në drejtësi për qytetarët që nuk kanë mundësi financiare për të siguruar përfaqësim ligjor, duke përcaktuar kritere specifike për përfituesit.⁶⁰ Tutje, një hap progresiv ishte marrë në shkurt të vitit 2022, me plotësim ndryshimin e këtij ligji, ku pavarësisht nga kriteret e kërkuara në nenin 8 dhe 9 të ligjit bazik⁶¹ për të përfituar nga ndihma juridike falas, kjo ndihmë është zgjeruar edhe për disa kategori tjera, në mesin e të cilëve janë edhe gazetarët.⁶²

Plotësim ndryshimi në këtë drejtim, me vendosjen e gazetarëve si kategori përfituese e ndihmës juridike falas, ndikon në fuqizimin e qasjes në drejtësi dhe siguri më të madhe ligjore ndaj gazetarëve.

Megjithatë, ky hap progresiv është pasuar me një tjetër mjaft regresiv kur në shtator të vitit 2022, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANjF) që ofron ndihmë juridike falas për kategoritë e lartcekura dhe që ishte themeluar në bazë të Ligji për Ndihmë Juridike Falas në Kosovës të vitit

linkun:

<https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22languageisocode%22:%5B%22ENG%22%5D,%22appno%22:%5B%2245581/15%22%5D,%22documentcollectionid%22:%5B%22CHAMBER%22%5D,%22itemid%22:%5B%22001-211777%22%5D%7D>, (Qasur për herë të fundit me 22 maj 2025).

⁵⁹ Shala, G. “Përgjegjësia e mediave ndaj komenteve të paligjshme”, Prishtinë, tetor 2024, faqe 13. https://kll-ks.org/wp-content/uploads/2024/10/Raporti_Pergjegjesia-e-mediave-ndaj-komenteve-te-paligjshme-1.pdf (Qasur për herë të fundit me 26 maj 2025.)

⁶⁰ Ligji nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2803> (Qasur për herë të fundit me 29 maj 2025).

⁶¹ Po aty, neni 8 (Kriteri financiar) dhe neni 9 (Kriteret financiare).

⁶² Ligji nr. 08/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, neni 10/A, pika 1.11. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2803> (Qasur për herë të fundit me 29 maj 2025).

2012, si agjenci e pavarur e mbikëqyrur nga Këshilli për Ndihmë Juridike Falas, kaloi nga një agjenci e pavarur në një agjenci të Ministrisë së Drejtësisë.⁶³

Në këtë formë ANjF nga një organ i pavarur, përfundoi në të politizuar dhe me këtë rast praktikisht janë fuzionuar edhe ndërgjyqësit, përkatësisht i padituri dhe paditësi.⁶⁴ Kështu, paradoksisht, për rastet e njëjta, Ministria e Drejtësisë do të duhet të kujdeset edhe për mbrojtën e interesit të qytetarëve edhe për mbrojtën e interesit të institucioneve publike. Pra, edhe për interesin e paditësit edhe interesin e të paditurit. Nën këtë rregullim të ri ligjor, qytetarët tanimë nuk kanë siguri të mjaftueshme juridike që për rastet e tyre që kanë nevojë për ndihmë juridike falas të kërkojnë ndihmë juridike nga ANjF. Kështu, ky rregullim ligjor, ka cenuar të drejtën e qytetarëve për ndihmë juridike falas, sipas standardeve të përcaktuara nga GjEDNj, standarde këto obligative në rendin kushtetues kosovar. Për këtë arsye, ky projektligj është në kundërshtim me nenin 31.6 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.⁶⁵

Sa është e rëndësishme ndihma juridike falas për gazetarët dhe mediat dëshmon fakti që organizatat joqeveritare si Instituti i Kosovës për Drejtësi përmes Qendrës për Ndihmë Juridike Falas kanë ofruar ndihmë juridike falas në dhjetëra raste, ku palë të dëmtuar kanë qenë mediat ose gazetarët.⁶⁶ Në këto raste, përmes ndihmës juridike falas janë fituar procese gjyqësore si të natyrës penale,⁶⁷ civile,⁶⁸ po ashtu edhe të natyrës administrative, por ligjërisht detyruese.⁶⁹

⁶³ Ligji Nr.08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënese të Agjencive të Pavarura <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=62599> (Qasur për herë të fundit me 29 maj 2025).

⁶⁴ Shala, G. “Politizimi kundër kushtetues i AFNJ”, Prishtinë, Tetor 2022, faqe 4 <https://kli-ks.org/politizimi-kunder-kushtetues-i-anjf/> (Qasur për herë të fundit me 29 maj 2025).

⁶⁵ Po aty, faqe 4 <https://kli-ks.org/politizimi-kunder-kushtetues-i-anjf/> (Qasur për herë të fundit me 29 maj 2025).

⁶⁶ Këto informata janë ofruar nga Qendra për Ndihmë Juridike Falas e IKD-së .

⁶⁷ “200 euro gjobë ndaj të akuzuarit për kërcënimin me jetë të gazetares dhe kameramanit”, betimiperdrejtesi.com publikuar më 16 gusht 2023. <https://betimiperdrejtesi.com/200-euro-gjobe-ndaj-te-akuzuarit-per-kercenimin-me-jete-te-gazetares-dhe-kameramanit-te-betimit-per-drejtesi/> (Qasur për herë të fundit me 30 maj 2025).

⁶⁸ “Aprovohet në tërësi padia e Grupit “Koha” ndaj Komunës së Prishtinës, anulohet vendimi për mbylljen e qarkullimit të mjeteve motorike në disa rrugë”, betimiperdrejtesi.com publikuar më 7 tetor 2024. <https://betimiperdrejtesi.com/aprovohet-ne-teresi-padia-e-grupit-koha-ndaj-komunes-se-prishtines-anulohet-vendimi-per-mbylljen-e-qarkullimit-te-mjeteve-motorike-ne-disa-rruge/> (Qasur për herë të fundit me 30 maj 2025).

⁶⁹ “KPM: RTK1 shkeli Kodin e Etikës kur transmetoi artikullin e “Slobodna Bosna”, obligohet t’i ofrojë Nacionales hapësirë për reagim”, betimiperdrejtesi.com publikuar më 24 shtator 2024. <https://betimiperdrejtesi.com/kpm-rtk1-shkeli-kodin-e-etikes-kur-transmetoi-artikullin-e-slobodna-bosna-obligohet-ti-ofroje-nacionales-hapesire-per-reagim/> (Qasur për herë të fundit me 30 maj 2025).

Rekomandimet

- Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendi duhet të miratojnë urgjentisht Kodin Civil.
- Të bëhet rishikimi dhe plotësimi i Ligjit për Familjen dhe Ligjit për Trashëgimi, për të përfshirë të drejtat e personave të gjinisë së njëjtë që bashkëjetojnë.
- Të rregullohet me ligj dhe akte nënligjore procedura për ndërrimin e gjinisë dhe emrit, përmes një procesi administrativ të qasshëm, të shpejtë dhe jo-diskriminues.
- Të miratohet Plani i Veprimit për të Drejtat e Personave LGBTIQ+, si dokument strategjik që adreson shërbimet, mbrojtjen dhe përfshirjen e këtij komuniteti.
- Kuvendi i Kosovës të zbatojë Rregulloren e Kuvendit në mënyrë strikte sa i përket gjuhës jo parlamentare në punimet e komisioneve dhe seancave plenare.
- Të fuqizohen kapacitetet e institucioneve të gjyqësorit për të trajtuar në mënyrë sa më efektive rastet që përfshijnë persona LGBTIQ+.
- Gjykatat të marrin për bazë natyrën e punës së të dëmtuarve – si gazetarë, në rastin e vlerësimit të rrethanave të rastit.
- Gjykatat të ashpërsojnë politikën ndëshkimore përmes shqiptimit të dënimeve meritore dhe në përputhje me Udhëzuesin për Politikën Ndëshkimore në çdo rast kundër gazetarëve dhe personave LGBTIQ+.
- Institucionet e Kosovës të miratojnë bazën ligjore adekuate, në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ashtu që të përcaktohet specifikisht me ligj përgjegjësia e mediave për komentet e paligjshme të postuara në publikimet e tyre në rrjetet sociale.

